



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS - MUNICIPALITY OF PEJA - OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

Nr. Protokolit: 01-06901-47186

Data: 18.06.2024

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

**THËRRET**

Të merrni pjesë në mbledhjen e VI të rregulltë për vitin 2024, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 28.06.2024 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

*Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

**RENDI I DITËS**

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalve të Kuvendit të Komunës së Pejës (seancës së jashtëzakonshme dt. 16.04.2024, seancës së dt. 26.04.2024 dhe seancës së dt. 28.05.2024).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.
6. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
7. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSBB-së.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar (për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Hënën me dt. 27 Qershor 2024).
9. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.



**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Z. Rexhep Kurtbogaj**

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

<b>TABELA E PROJEKTEVE KAPITALE 2025-2027</b>		<b>Vitet preliminare</b>	
Emri i Projektit	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
163190 - Administrata - Pejë			
Blerja e veturave	150,000.00	140,000.00	
Ndërtimi i Objektit të Administratës		200,000.00	200,000.00
Rindertime ne objektet e Administrates dhe zyrave të Vendit		50,000.00	
Blerja dhe instalimi i pompes termike për objekt të Administrates		100,000.00	
Ndërtimi i objektit të administrates në Vitomerice	150,000.00		
<b>Totali - Administrata dhe Personeli</b>	<b>300,000.00</b>	<b>490,000.00</b>	<b>200,000.00</b>
175190 - Buxhet dhe financa			
Participim me fondin e performancës dhe Ministrit e Linjës			
Participim me Ministrit e Linjës dhe donator -2025	150,000.00	1,000,000.00	1,099,841.23
Asfaltimi I rruges ne Drelaj	300,000.00		
Asfaltimi, ndriçimi dhe ndertimi i trotuarit ne rrugen “ Mustafe Hasanaxhekaj – Mic Nimani “ (Vitomerice – Treboviq)	344,378.50		
Kubezimi i trotuareve dhe rregullimi i hapësirave ne Treboviq , Katund i Ri dhe Bllagaj	276,974.76		
Turizmi i aventures ne Komunen e Pejes	57,210.00		
Asfaltimi i rruges “Lugagji- Jabllanice e Gjakoves	58,450.13		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne fshatin Raushiq	30,924.00		
Vazhdimi i ndertimit te trotuarit dhe ndricimit ne fshatrat Ruhot deri ne Trestenik dhe ndricimi ne fshatin Llabjan(Rr.Sterio Spase)	21,116.00		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne rrugen Isa Haxhijaj ne fshatine Dubove	15,129.40		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne fshatin Baran deri tek hyrja ne fshatine Vranoc dhe hyrja ne fshatin Kotradiq	23,788.00		
Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Boge	19,930.00		
Ndertimi i ndricimit publik nga rrethi Vitomerice deri te shkolla (Rr.Hasan Muratagic)dhe ndricimi ne fshatrat Kotradiq,Kristal(Lagja e Bujupt)dhe Radac (Rr.Shaqir Demaj)	18,415.00		
Ndertimi dhe rregullimi i hapsirave publike tek uji i zi dhe ndertimi i murrit dhe ndricimit te Zikliqt	46,948.50		
Ndertimi i hapsires perreth stadionit ne fshatin Brestovik	34,600.00		
Vazhdimi i ndertimit te trotuarit dhe ndricimi nga fshati Vitomerice deri te fshati Novoselle(Rruga R106)	23,418.00		
Ndertimi i trotuarit prane stacionit te autobuseve	13,637.00		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne lagjen Aslan Qeshime,rregullimi i hapsires publike ne Qendren Zajtare dhe te Ura e Gurit	16,000.20		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne fshatrat Loxhe(Rr.Deme Isufi)dhe ne rrugen Hida Halimi ne lagjen Dardania	44,727.00		

Kubezimi i hapsirave publike ne lagjen Fidanishte	10,310.00		
Ndertimi i taoleteve publike ne fshatine Radac dhe rregullimi i hapësirave publike tek Hasan Beqë ne fshatin Qyshk renovimi i shtepise ne fshatine Klicine dhe ndertimi dhe rregullimi i hapësirave ne lagjen Karagaq(Rr.Sali	12,000.00		
Turizmi kulturor-Diversifikimi i ofertes turistike permese trashigimise kulturore dhe promovimi i traditave	31,511.50		
Ndertimi i trotuarit dhe ndricimi publik ne fshatin Lozhan deri te Shkolla	10,220.00		
Ndertimi i hapsires publike ne fshatin Koshutan-Rugove	7,896.00		
Ndricimi i hapsirave publike ne lagjen Fidanishte	13,005.00		
Ndertimi i shtepise se fshatit per nevoja te ndryshme te banoreve ne fshatin Ozdrim	16,488.48		
Ndertimi dhe rregullimi i shtigjeve ne parkun Karagaq	47,001.00		
Ndertimi i ambulantes ne fshatin Trestenik	24,221.00		
Ndertimi i trotuareve dhe rregullimi i hapsirave publike ne fshatrat Leshane,Kliqine,Gllaviqice dhe Jabllanice	127,402.66		
<b>Totali - Buxhet dhe Financa</b>	<b>1,795,702.13</b>	<b>1,000,000.00</b>	<b>1,099,841.23</b>
<b>180190 - Infrastruktura Rrugore - Pejë</b>			
Ndërt. ujësj. në Stankaj, Bogë, Shkrel, Pepaj, Malaj, Shtupeq i Madh, dhe Kuqishtë	200,000.00	200,000.00	
Ndertimi i rrugëve në Novosell, Jabllanic e Madhe, Jabllanic e Vogel, Dubovë dhe Radac	140,077.15		
Ndërt. i rrug. në Kosuriq, Rashiq, Baran, Baran i Epërm, Kotradiq, Turjak, Llugagji dhe Glllogjan	144,777.11		
Ndërtimi i rrugëve në Kamenice, Babiq, Pishtan, Millovanc, Poqest dhe Vragoc	41,847.15		
Nërt. i rrug. në Nabërgjan, Terstenik, Ruhot, Zahaq, Llabjamn, Katund i Ri dhe Qyshk	167,988.00		
Ndërtimi i rrugëve në Raushiq, Loxhë, Graboc dhe Llozhan	255,423.05		
Ndertimi i rrugëve te bazeni madh bollepoje , jarine - burgu oricredit banke			300,000.00
Ndërtimi i Kanalizimit Raushiq-Loxhë - impianti	230,000.00		
Ndertimi i Sheshit Hotel Korze - Ura e zallit	120,000.00		
Asfaltimi i Rruges Sejnovë - Gjore	300,000.00	300,000.00	
Ndertimi i Ures se automjeteve Kapeshnicë - Qendër	129,736.50		
Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë	382,247.62	969,675.52	1,200,000.00
Rregullimi i Shetitores prej Ures se Novoselles - Mulliri Berdynajve	100,000.00	300,000.00	300,000.00

Rindërtimi i rrugëve në Rugovë nga reshqitjet e dheut në fshatrat: Pepaj, Kuçishtë, Bogë dhe Majën e Zezë	20,000.00	200,000.00	200,000.00
Ndërtimi i rrethojave të varrezave nëpër fshatrat: Broliq, Lutogllavë, Dardani 3, Zllapek, Maja e Zezë, Jabllanice e Madhe dhe Çallapek	78,800.00	50,000.00	50,000.00
Ndërtimi i Varrezave me rrethoja metalike	150,000.00		
Ndërtimi i Kanalizimit në lagjet Kapeshtice, Lagjen e Gurit, Lagjen Kristal, Fshatin Baran	50,000.00		
Rindërtimi i Murit të lumit dhe mveshja e murit me gurë	180,000.00		
Ndërtimi i rrugëve në Rekë të Allagës - Pecaj, Varri Sykut Llaz-Bellopaq, Shtupeq I Madh - Qafa e Broqit, Dukaive, Kucishtë, Koshutan, Bogë-Shkrel, Podi Jaku	1,100,000.00		
Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme - shpronsime - impianti Gorozhdec	800,000.00	800,000.00	400,000.00
Ndërtimi Sheshit Shkelzen Haradinaj - Haxhi Zeka		1,000,000.00	1,000,000.00
Ndërtimi i Hapësirave të Drini i Bardhe		200,000.00	200,000.00
Ndërtimi i rrugës së Bjeshkës së Jabllanices së Vogel		300,000.00	300,000.00
Ndërtimi i rrugës Varri i Sykut - Qafe Hajle		500,000.00	500,000.00
Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme	123,185.00	150,000.00	
Ndërtimi i impiantit në fshatin Kryshec	200,000.00		
Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit	200,000.00	500,000.00	
Ndërtimi i impiantit në Kuçishtë			750,000.00
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Kamenicë, Çallapek, Zllapek, Kryshec dhe Turjakë	89,548.30		
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Zahaq, Qyshk, Katundi I Ri, Leshan, Kliqinë, Ozdrim dhe Dubovë	157,790.00		
Ndërtimi i rrugëve dhe trotuarve në qytet	500,000.00	500,000.00	800,000.00

Ndertimi I rrugeve ne fshatra	600,000.00	500,000.00	800,000.00
Nndertimi I sheshit prej ures se zallit deri te		500,000.00	500,000.00
Rregullimi I infrastrukures per rreth bizneseve ne hapsirave publike	150,000.00	250,000.00	250,000.00
Ndertimi I rruges ne zonen industriale ne Zahaq	100,000.00		650,000.00
Ndërtimi i rrugëve në lagjet Karagaq, Kapeshnice dhe Puhovc, Jarine, Asllan Çeshme, Xh.Kada dhe Kristal	185,459.24		
<b>Totali - Infrastruktura Rrugore - Pejë</b>	<b>6,896,879.12</b>	<b>7,219,675.52</b>	<b>8,200,000.00</b>
195950 - Zyra komunale për komunitete dhe kthim			
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Vitomiricë, Zllapek dhe Çungur dhe Brestovik	537,090.00	420,000.00	450,000.00
<b>Totali - Zyra komunale për komunitete dhe kthim</b>	<b>537,090.00</b>	<b>420,000.00</b>	<b>450,000.00</b>
470190 - Bujqësi - Pejë			
Ndërtimi kanaleve të ujitjes në regjionin e lugut të Baranit, Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fusha e Pejes	500,000.00	450,000.00	475,660.00
<b>Totali - Bujqesia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</b>	<b>500,000.00</b>	<b>450,000.00</b>	<b>475,660.00</b>
480190 - Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik - Pejë			
Projektet e zhvillimit ekonomike	200,000.00	200,000.00	200,000.00
<b>Totali - Zhvillimi Ekonomik</b>	<b>200,000.00</b>	<b>200,000.00</b>	<b>200,000.00</b>
661000 - Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ - Pejë			
Ndërtimi i kanaleve të Seravisë, Katundi I ri dhe fshati Zahaq	250,000.00	200,000.00	200,000.00
Gjelbrimi i hapesires se rrugeve ne qytet , Ura e Gurit-Duli dhe Tranzit	30,000.00	40,000.00	50,000.00
<b>Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi</b>	<b>280,000.00</b>	<b>240,000.00</b>	<b>250,000.00</b>
741000 - Shërbimet e shëndetësisë primare			
Ndërtimi i qendres multifunkionale të trajnimeve faza 2 në lagjen 2Korriku	250,000.00	200,000.00	
Rindërtimet ne QKMF -et	64,271.00	200,000.00	
Ndërtimi i QMFsë në Radac		100,000.00	100,000.00

Blerja e paisjeve mjekesore aparat Radiologjik, Ortopan, aparat oksigjen formuese dhe autokllav	60,000.00	80,000.00	60,000.00
Ndertimi i Objektivit te ri te QKMF-se		544,025.38	700,000.00
<b>Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale</b>	<b>374,271.00</b>	<b>1,124,025.38</b>	<b>860,000.00</b>
<b>755920 - Shërbimet Rezidenciale</b>			
Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuar në Vitomericë	100,000.00	150,000.00	100,000.00
Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuar		250,000.00	200,000.00
Shtëpia për mbrojtjen e fëmijëve	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Shtëpia e komunitetit për persona të moshuar	230,000.00	500,000.00	600,000.00
<b>Totali - Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale</b>	<b>380,000.00</b>	<b>950,000.00</b>	<b>950,000.00</b>
<b>850190 - Shërbimet Kulturore</b>			
Ndërtimi i palestres në Zahaq	330,000.00		
Blerja e inventarit në Qendrën Rinore Vitomericë dhe në Qendrën Kulturore Peja			
Rindërtimi i fushes së Basketbollit Valon Begolli si dhe Rindërtimi i Tereneve të tenisit Arben Zeka në Brestovik			
Ndërtimi i Murit mbrojtës në Fushën e Futbollit në Novosellë dhe rindërtimi i zhyshitoreve			
Mbulimi i bazenit të hapur dhe vendosja e Outdoor fitnessit në parkun e vogël			
Blerja e arenës profesionale për boks si dhe skenës profesionale për ambiente të hapurave			
Ndërtimi i shtegut të Atletikës në lagjen Dardania			
Ndërtimi i palestrës së ish Partizanit për sportet luftarake dhe atletike	200,000.00	400,000.00	300,000.00
Ndërtimi i fushave të Voleyballit në lagjen Dardania dhe në Parkun e Madh		30,000.00	
Ndërtimi i Palestres së basketbollit në Lagjen Karagaq		200,000.00	500,000.00
Ndërtimi i bibliotekës së Qytetit			550,000.00
<b>Totali - Kulturë, Rini, Sport</b>	<b>530,000.00</b>	<b>630,000.00</b>	<b>1,350,000.00</b>
<b>Arsim dhe shkencë</b>			
Blerja e kombibusve për shkollat	175,000.00		
Ndërtimi i Palestrës së Sportit në Fshatin Treboviq	100,000.00	200,000.00	

Ndërtimi i Palestrës së Sportit në Fshatin Llozhan		200,000.00	100,000.00
Ndërtimi i sallës së sportive në Glllogjan	100,000.00		
Rindërtimi i Shkollave dhe Anekseve ne Nabergjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, Nabergjan dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice	300,000.00	300,000.00	301,894.00
Ndërtimi i shkolles te stacioni I autobuseve			800,000.00
Ndërtimi i qerdhes ne fsh Zahaq dhe Stacioni i Trenit			800,000.00
Ndërtimi i Palestrës së sportit në Trestenik	100,000.00	150,000.00	
Ndërtimi i Palestrës së sportit në shkollen fillore Smajl Hajdari			400,000.00
Ndërtimi i palestres së sportive në Kryshec		200,000.00	200,000.00
Ndërtimi i palestres se sportit ne Dubove			400,000.00
Ndërtimi i Gjimnazit	1,000,000.00	1,444,025.38	
<b>Arsim dhe shkence</b>	<b>1,775,000.00</b>	<b>2,494,025.38</b>	<b>3,001,894.00</b>
Totali - Arsimit dhe Shkencës			
<b>635 Totali</b>	<b>13,568,942.25</b>	<b>15,217,726.28</b>	<b>17,037,395.23</b>















REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT  
MAYOR OFFICE  
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 13.06.2024, merr këtë,

### K o n k l u z i o n

**I propozohet** Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim dhe aprovim që i nijeti material të dërgohet në Kuvend për Shfuqizimin e Vendimit nr 22/2019 me nr protokolli 463-01/48816 të datës 30 prill 2019 KK Pejë mbi mbi Shpalljen e Interesit Publik për Ndërtimin e Impiantit të Ujerave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastrën kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë e pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Sekretaria e Kuvendit Komunal në Pejë dhe DÇPJ.

Konkluzioni i dërgohet:

- Kuvendit Komunal në Pejë,
- Anëtarëve të KPP
- DÇPJ
- Arhivës.

I.nr. 163-01/46363 2024  
Pejë, 13 Qershor 2024

KOMUNA E PEJËS



  
Gazmend Muhaxheri  
Kryetar i Komunës



<i>Datë/Nr.</i>	<i>12.06.2024 /Nr.15-463-LP-33/2019</i>
<i>Për:</i>	<i>Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit Komunal të Pejës</i>
<i>CC:</i>	<i>-Të gjithë anëtarëve të Kuvendit Komunal të Pejës -Komitetit për Politik dhe Financa -Drejtorisë për Çështje Pronësore –Juridike</i>
<i>Nga:</i>	<i>Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës</i>
<i>Lënda:</i>	<i>Propozim Mbi Shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.prot:463-01/48816 datë 30 prill 2019 të Kuvendit të Komunës së Pejës mbi Shpalljen e Interesit Publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.</i>

Te nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenit 53 par.1 të Ligjit mbi Proceduren e Përgjithshme Administrative (Ligji nr.05/L-031 i Republikës së Kosovës),Kryetari i Komunës së Pejës parashtron Kuvendit Komunal Pejë, këtë:

### PROPOZIM

**Shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.prot:463-01/48816 datë 30 prill 2019 të Kuvendit të Komunës së Pejës mbi Shpalljen e Interesit Publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.**

### Arsyetim

Me Vendimin nr.22/2019 me nr.prot:463-01/48816 datë 30 prill 2019 është miratuar propozimi për shpalljen për Interes publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.Pasi që janë zhvilluar procedurat e shpronësimit dhe vlerësimi pronës është bërë nga ana e Departamenti i Tatimit në pronë, pala e pa kënqur me çmimin e vlerësimit ka bërë padi në Gjykatën Themelore në Pejë vetëm sa i përketë çmimit të vlerësimit të pronës, Gjykata sipas kërkesës së palës ka caktuar një ekspert financiar për vlerësimin e çmimit të tregut dhe ka nxjerr përfundim me dyfishimin e çmimit nga ai që është caktuar nga ana e Departamentit të Tatimit në Pronë, andaj Komuna në këtë rast nuk shpreh interes për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme të shpronësimit dhe heqë dorë nga kjo pronë për interes publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq .

Bashkangjitur:

- Vendimit nr.22/2019 me nr.prot:463-01/48816 datë 30 prill 2019 mbi Shpalljen e Interesit Publik



**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I. Numër: 463-01/48816, dt. 30. Prill 2019.**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, dhe nenit 17 paragrafi 1 pika b) i Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale të Republikës së Kosovës, (Gaz.Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, dt.04.06.2008), nenit 4 paragrafi 2. nënpika 2.4.1 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronsimin e pronës së paluajtëshme, nenit 8 dhe nenit 14 paragrafi 1 pika b) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.nr.09-8103 dt.29.09.2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur 30. Prill 2019, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, muar këtë:

**V E N D I M**

**Nr.22/2019**

**MBI SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK**

**I. MIRATOHET** propozimi i Drejtorisë për Çështje Pronsoro-Juridike për shpalljen e interesit publik, për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujrave të zeza në fsh.Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK në sipërfaqe prej 3900 m<sup>2</sup> ZK Raushiq pronë e pronarit privat Naim (Syl) Fetahaj të identifikuar në qerifikatën e pronës.

Realizimi i projektit për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujrave të zeza në fsh. Raushiq prek interesat private pronsore.

**II.** Shpallja e interesit publik bëhet me qëllim që patundëshmëritë të përshkruara në pikën I të këtij Vendimi të kalojnë në pronësi të Komunës, pas një procedure të shpronimit, për realizimin e qëllimit publik, për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujrave të zeza.

**III.** Prona e shpallur si interes publik në pikën I të këtij Vendimi do të shërbej ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.

**IV.** Në bazë të këtij Vendimi, autorizohet Kryetari i Komunës të inicoj procedurat e mëtutjeshme për shpronsimin e pronës në fjalë për interes publik konform dispozitave ligjore në fuqi.

**V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për çështje Pronsoro-Juridike.

**VI.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

**KREYESUESI I KUVENDIT**

**Dr.Islam Husaj**



**Dorezohet:**

1x1. MAPL.

1x1.Kryetarit të Komunës

1x1.DÇPJ.

1x1.Arkivë.



## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: \_\_\_\_\_,

Në bazë të nenit 11 dhe 12 shkronja (d) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenit 53 par.1 dhe 3 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji nr.05/L-031 i Republikës së Kosovës), , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30 shtator 2020, në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës ,Kuvendi i Komunës në takimin e mbajtur me \_\_\_\_\_ mori këtë:

### D R A F T V E N D I M

Nr. \_\_\_/2024

**Mbi Shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.prot:463-01/48816 datë 30 prill 2019 të Kuvendit të Komunës së Pejës**

- I. **SHFUQIZOHET** - Vendimi nr.22/2019 me nr.prot.463-01/48816 datë 30 prill 2019 mbi Shpalljen e Interesit Publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.22/2019 me nr.prot.463-01/48816 datë 30 prill 2019 KK Pejë mbi Shpalljen e Interesit Publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim(Sylë) Fetahaj dhe nuk prodhon efekt juridik.
- III. Komuna nuk ka interes juridik për vazhdimin e procedurave të shpronësimit të kësaj ngastre të shpallur si interes publik sipas vendimit nr.22/2019 me nr.prot.463-01/48816 datë 30 prill 2019 mbi Shpalljen e Interesit Publik për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Zeza në fshatin Raushiq në ngastren kadastrale 254/1 ZK Raushiq pronë pronarit privat Naim (Sylë) Fetahaj.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoresh -Juridike.
- V. Ky vendim hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas pas publikimit në web faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**REXHEP KURTBOGAJ**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

**I. Numër: 400-01/27657**  
**Pejë, datë: 16 prill 2024**

### PROCESVERBAL

Nga takimi i **-I-** i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **16 prill 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, znj. Hajrije Hxhijaj- zyrtare kryesore e financave, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 32 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 20 votë pro, 12 votë kundër, 1 votë e përmbajtur, u miratua kjo pikë e rendit të dites për shqyrtim, me propozimin që u dha nga kryetari dhe nga drejtoria e financave,

#### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për rialokim dhe transferin e mjeteve buxhetore.

#### 1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z. Rustem Berisha dhe z. Granit Kelmendi.

## **2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.**

Nuk ka pasur.

## **3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për rialokim dhe transferin e mjeteve buxhetore.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kërkesë e cila ka ardhur nga kryetari dhe drejtoria për financa, kjo kërkesë ka rrjedh si pasoj e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në vitin e kaluar. Pastaj departamenti i thesarit dhe trasfereve ka debituar llogarinë e komunes. Si pasojë komuna është e obliguar që mjetet të barten në investime kapitale, për sqarime me tutjeshme kryetari është prezent dhe e hapim diskutimin.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne e kemi bërë propozimin për transfer vetëm ta shohi kush ka me debatë dhe e kryjmë këtë punë.

z.Naim Bytyqi: po ju drejtohem juve koleg asambleist sepse ekzekutivët ju kom drejtu që dy vjet, dhe nuk kanë marr masa dhe po ju drejtohem juve sot. Me lejoni të nderuar asambleist që në pika të shkurta të elaboroj rreth këtij problemi që jemi mbledh sot ktu. Ky problem rrënjët i ka tek nënshkrimi i kontrates kolektive, të cilën ishte nënshkruar në atë kohë përmes qeverisë dhe SBASHK-ut. Këtu si duket kanë mbetur pa u involvuar komunat, ku është bërë marrveshja pa u analizuar financiarisht dhe nuk është definuar kodi i veçantë për pagesat kolektive që burrojnë nga kjo kontratë duke përfshirë shujtat, inflacionet dhe pagat jubilarë. Ndëshkimi nga lëndët përmbartimore në mungesë të mjeteve nga kategoria e pagave, mjetet janë marr nga kategoria e investimeve kapitale. Në këtë rast janë demtuar disa projekte të cilat ishin në projekt, të cilat përgjegjësit për buxhetin ishin dasht me i parapa me kohë. Kjo është arsya që është shfaqur sot për të bërë transfere, dëm i cili është bërë dhe mund të jetë sidomos për investimet e reja. Në muajin tetor kur u morën mjetet nga përmbartimi, unë pata kërkuar nga komuna që të kërkojë ndihmë nga ministria e financave për mbulimin e këtyre mjeteve. Me datë 30 tetor unë pata reaguar që shërbyesit civil të komunës së Pejës do të mbesin pa paga, sepse isha i sigurt që kategoria për paga dhe meditje ishte e zbrazët. Sepse mjetet u morën nga ndëshkimet e lëndëve përmbartimore për shujta të arsimtarëve, tani komuna nuk ka mjete mi pagu ato paga e disa qka do të ndodhë sa here që vishin transfere. Pas disa ditësh u bë lajm reagimi im në disa portale, unë tregova që kategori e pagava dhe meditjeve nuk ka më mjete! Dhe a dini se çka ndodhi më tutje që drejtoria e financave mëhere e morë vendim që pjesën e mungesës së mjeteve për pagat dhe shujtat e arsimtarëve, ti mar në kategori të tjera siq janë investimet kapitale, ashtu edhe doli siq deklarova . Të nderuar koleg asambleistë më lejoni të j'u sqaroj me fakte, se pse sot nuk duhet të marim pjesë në transfere apo rialokime të mjeteve të cilat nakanë thirrë këta zotërinjtë këtu! Dua të rikujtoj që me datë 21 tetor është bërë Plani i punës së kuvendit dhe keni qenë prezent edhe ju në takimin në Durrës. Unë, e kam pas një kërkesë të vetme që të krijohet një komision duke përfshirë edhe anëtarët e pozitës që të formohet për mbikqyrjen, analizimin e projektit të buxhetit që të mos biem ndesh kur vjen koha me votu buxhetin, por paraprakishtë të dakordohemi dhe të marim pjesë edhe opozita. Më pat reagu dr.Islam Husaj dhe e ka miratuar, dhe ka thënë që një

komision i tillë është i mirë se ardhur dhe i ndihmon shumë zyrtarëve komunal të buxhetit. Meqenëse ai komision nuk është kriju kurrë , ndihmet dhe sygjerimet tona komunës nuk i vyften kurrë, atëherë për çka po ju vijnë sot vota jonë për çka na keni thirrë? Çka nënkupton moskrijimi i këtij komisioni? Çka po mshefni prej neve? A na keni thirrë sot me ju mbulu dështimet, mosdijen, keqmenaxhimin, keqklasifikimin? Çka po kërkoni prej neve sot a me ju ndihmu edhe na me shkel ligjin, a çka me bo na sot? Por jam shumë i sigurt se qytetarët dita dites janë tu e kuptu që paraja e tyre është duke u keqmenaxhu nga ata që të cilët janë të thirrur për me mbrojtë buxhetin. Po ashtu e di që edhe mbas kësaj seance kryetari ka me thonë që opozita po pengon, edhe po kryetar opzita ka me të pengu, sa mundohesh me keqpërdor dhe sa mundohesh me shkel ligjin, dhe sa të jemi na gjallë nuk ke me mujt me shkel ligjin. Andaj të dashur asambleistë, ekzekutivi në ditet në vazhdim nese vazhdon në këtë formë, komuna do të shkoj drejt falementimit. Por unë në ditet në vijim do të bëj transparente projektet që kryetari ka premtuar se do ti kryej në këtë mandat dhe ato nuk po kryhen, po ashtu do të bë publike edhe projektet që po pezullohen në të ardhmen. Do të ju shpjegoj të gjithë qytetarëve do të shkoj në çdo lokalitet, shpi me shpi, nuk ka me thonë mo opozita po e bllokon por do ju qes me fakte. Nese ma lejon ligji do ju qes edhe emrat e asambleisteve, këtu po ju involvoj edhe juve koleg nese votoni, edhe emrat e juve nese ma lejon ligji do ti bëj publike se kush ka ndihmu në këtë keqmenaxhim. Po ju drejtohem juve asambleista Atdhe, dr. Islam, dr. Sadri, znj. Xhevahire dhe kjo vlen edhe për Fatimen e Leotrimin dhe të gjithë, që të mendoni mirë para se te votoni. Po ashtu më lejoni që të ju shpjegoj, e kam ilustru një rast shumë thjeshtë se çka po ndodh me kategorit buxhetore.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: është mirë me ndejt Naim kur ju shkrun fjalimet dikush dhe me dëgju përgjigjen, se krejt fjalimet janë duke ti shkru dhe vetem një send po të them, atyre që ta kanë shkru fjalimin tregoju punen e dhelpra me dashin. Një gjë me ju shpjegu asambleista ky u mundu me kon i saktë se ja ka shkru dikush tjetër fjalimin, deri aty që na kanë marr paret prej pagave ke i saktë. Por nuk i ka mbulu qeveria paret që janë marr prej pagave, por i ka mbulu në tetor i ka qit me 2 milionë euro, për me i mbulu pagat e 3-mujorshit të fundit. Na i kanë marr 2 milionë e 700 mijë euro të investimeve kapitale në muajin dhjetor, e ky që foli dhe ata që ja shkrujnë fjalimet duhet me dit që në dhjetor skemi pas as seancë as mundësi me i mbulu. Buxhetit komunal ministria e financave ja ka marr dilkur rreth 3 milionë euro që nuk ke pas me i mbulu, e na duhet me rialoku një pjesë të buxhetit me qit në investime të cilat janë të nevojshme dhe një pjesë tjetër me ndal dhe me lon për vitin 2025. Pra ne në asnje projekte nuk hekim dorë por këto projekte që janë të nënshkruar kontratat dhe jaqnë duke u zhvillu projektet, duhet me i mbush me buxhet.

Z. Islam Husaj: më intrigoj kolegu ynë me fjalimin që e prezentoj, por nuk është në rregullë prej tij dhe prej votuesve të tij që e lëshon takimin dhe largohet pa e marr përgjigjen për ato se çka foli! Kur e kemi bo planin e punës së kuvendit ne kemi thënë që egziston komisioni i cili e propozon buxhetin është Komiteti për Politikë dhe Financa, përfaqsesit të financave të ekzekutivit, dhe të tjeret që kanë marr pjesë në dëgjimet buxhetore në vazhdimësi. Prej vitit 2013- e deri më tash gjithmonë janë bajt mbi 10 takime buxhetore. Nuk është e saktë që kemi

thënë që duhet me u formu grupi si komision prej asambleistave prej opozites, sepse opozita e ka pas mundësinë me marr pjesë në Planifikimin e buxhetit tër kohen, prej muajit maj-shtator kur është aprovu buxheti, ata kanë pas mundësi me qenë pjesë e planifikimi të buxhetit. Edhe me dëgjimet buxhetore, edhe me propozimet e tyre, por edhe me kërkesat të cilat kanë mujt me i bo! Uhnë, nuk e di që kët kanë bo ndonjë kërkesë drejtuar kuvendit apo qoftë ekzekutivit për një projekt të cakuar se duhet qe ky me hy në buxhet, dhe sot flasin. Por e kuptoj që është viti i parafundit dhe duhet me lëviz diqka, por me këto diskutimi po mendoj që vetem po e dëmtojnë veten dhe po e forcojnë anen tjetër sepse nuk po kanë argumente me dëmtu këtë pushtet. Kush e ka bo kontraten kolektive? E kemi bo na apo e ka bo kryetari ynë, apo kush e ka nënshkru kontraten kolektive ajo po dihet, është bashkëpërfaqësuesi i tyre që ka qenë aty. Kontrata kolektive pa buxhet të planifikuar nga qeveria nuk është dasht me u bo, në vazhdimësi ekzekutivi ynë ka reagu dhe ka kërku që ajo kontrat kolektive të mbulohet dhe të rimburohet me mjete nga qeveria mirpo asnihere nuk e kanë bo! Dhe këto janë vendime gjykate nuk mundet askush me i ndryshu, prandaj unë mendoj që ka fillu para përgatitja për fushat mirpo nuk shkon kështu, sespe edhe unë kam qenë opozit dikur e kam pa si duhet me u bo por jo në këtë menyrë duhet me argumente dhe me propozime konkrete se si duhet me dal me bo zgjedhjen!

Z.Berat Ganiqi: meqenëse na keni thirrë si mbledhje e jashtëzakonshme kisha parapa që sot më mirë kishte me qenë me na thirr një mbledhje për situaten dhe sigurinë në Pejë se sa për kto mjete trasfesre që kanë pas kohë me ndodh. Po ashtu pajtohem që duhet me përdor fjalor të matur e jo të rrugve si në rastin kur kryetari ju drejtu asambleistëve dhe tha tash e paloj këta, ky është fjalor i rrugëve as i kuvendit komunal e as i kërkujuna. Është hera e dytë që të dëgjoj ty kur thush tash e paloj këto dhe kjo është fjalor i rrugëve. As ata nuk kanë pas drejt me ju kritiku juve sepse e kanë votu buxhetin të vitit kaluar, dhe as me tregu ktu se kush është pozitë e opozitë më shumë. Ju e dini se në Pejë thojnë kur je shpitanik i mirë i rruan do pare për raste të rronda e ju jeni tregu shpitanik i keq! Jeni shku ja keni jep Keds 400 mijë euro subvencion duke e dit se çka po të pret, mos më thuj qe se ke dit ti që këto raste i ke pas në gjykatë se i ki pas, dhe mos më thuj qe se ki ditë që kanë me ta fitu landen se kur ka fitu i pari ka me ta fitu edhe i 100-ti. Por nuk ki dasht me i ruajt qato pare se ki dasht me subvencionu Keds dhe qesi firma të cilat ki mendu që kanë me të bo qerak! Buxheti i Pejes është dëmtu u tha këtu qeveria, mirpo cekeni se cila qeveri i ka nënshkru kontratat kolektive, bashkarishtë ju me ata që keni qenë në pushtet i keni pas kualicionet e mshefta për me rrëzu një qeveri tjetër, cekeni mos i leni njerzit me mendu që kjo qeveri ju ka bo!. Sot si pasoj e leni rrugen e Sejnov Gjorë me mungesë të buxhetit, deponin e mbeturinave në Sferkë me mungesë buxhetit, ndërsa nuk na tregohet se ku janë marr këto pare dhe cilat kode janë dëmtu? A ka ndonjë projekt që nuk ka me u realizu hiq ka mbet pa pare? Si asambleistë jemi të mangët në informacion krejt është ktu problemi, sespe p.sh i merni prej 9 –të shkollave buxhetin që kanë me u bo anexet e tyre kanë me u bo rregullimet e i qon në një shkollë kjo nuk është barazi kjo është dëmtim! Gjethku është mundu me i nda 20 mijë euro për rrugë dhe sot e din se në qfarë gjendje e ki Pejën, por mire e keni kryetar se seancën e kaluar keni thënë që në 2025-en Fatmiri i rregullon rrugët, se vet për deputet e po don me braktisë Pejën për me i ikë ketij problemi sepse e din që çfarë problemi është kriju në financa,e jo kryetar mbaje

tash deri në fund, trego nese je komnadant në mujsh me dal prej kësaj zgjidhje, realitet dhemb jeni tregu shtëpiak i keq!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: se sa jam i qëndrueshem i kom tregu kryeministrit, dhe i tegoj prap kur vjen puna se kush është më i qëndrueshem! A për punen e deponisë po të tregoj që janë hek paret sespe kryeministri i yti na ka shti në sanksione, sespe une i kam nda 1 milionë euro me mbaru deponin por ky na ka shti në sanksione e jo prej Bashkimit Evropian, dhe sivjet nuk mundem me u përdor, tregoj Berat edhe kryeministrit edhe ministrit financave se si pasoj e sanksioneve deponisë duhet me ja hek paret sepse paret që nuk i përdor këtë vit i qes i përdori këtë vjet, dhe vitin tjetër i ndaj prap për deponi për këtë jam shprijanik i mirë. Për keto sende se kush e ka menaxhu paren mirë e ka tregu qytetari 3 here e ka jep voten, dhe heren e 4-të e tregon në vitin 2025, dhe unë sa ka me mujt kam me i mbrojtë qytetarët sepse jam i thirrur për shkak të votes që ma kanë jep sespe mos me pas qenë vota dhe me qenë i zgjedhur ndryshe isha shku te shpija dhe nuk ish mar me këtë punë, por e kam besimin e dikujtë që unë i kryj punët mirë dhe është besim i madhë i dhënë me votë pa asnjë dhunë, është votë e qytetarit dhe ajo më bën me i qëndru gjethkujtë përpara dhe mos me u kthy mbas!

Z.Berat Ganiqi: sa për qendrushmerinë tonde tregohet kur ke qenë në Orë je dal ki kajt qe ti kanë vjedhë votat dhe je shku ju ki drejtu atij kryetarit dhe ju ke bo drejtor, qe qëndrushmeria dhe dorëzimi yt! Kryeministri nese ka hi ne sanksione ka hi me mbrojtë në interes atje në Veri, që ti dhe shumë të tjerë e keni dorëzuar, ai është i interesuar për shtet e sheti është duke u bo dhe pushtetit ty po ta jepim shihemi në vitin 2025.

Z.Sadri Berisha: Berat, me i mbajt ju patriotizem z.Gazmend Muhaxheri, është njëjtë si me shku une tek Papa me mbajt ligjerata për krishterizmin.

Z.Berat Ganiqi: kemi ardh me mbajt ligjerata se kqyr çfarë për fjalori po përdor edhe kjo mjafton për kryetar, kërkush nuk ja ka qit në krah patriotizmin dhe si ka thonë kekrush shpijun se unë sjom marr me keto sende në këtë seancë kurrë , po këtu nuk keni nevoj me ardh me tregu sa e doni se nesoer ju bjen e nuk ja qelni deren!

Z. Sadri Berisha: sa e dojmë na nuk ka rëndësi, sespe e ka tregu qytetari me voten e tij të lirë.

Znj.Hajrije Haxhijaj: ne këtë pikë të rendit të dites e kemi dorëzuar duke u bazur në ligjin e menxhimit të financave politike dhe përgjegjësit dhe ligji mbi ndarjen buxhetore neni 15 të i cili i lejon këto rialokime dhe transfere. Unë, e ceka që shumën prej 1,270,356 euro kemi kërku me bo rialokim dhe transfer ku prej tyre 722,446.53 euro kanë me u rialoku në projekte të njehta te drejtoria e sherbimeve publike dhe 113,695.00 euro rialokohen në programin arsim dhe shkencë kryesishtë në arsimin fillor. Desha të cekë një gabim tek ne faqen 2 ku ceket trasferi i mjeteve prej 454,274.77 euro nuk duhet të jetë 454 mijë euro, por duhet të jetë 434,274.77 euro. Po ashtu e kemi edhe një përmisim te kodi i projektit ndertimi i depos për nevoja komunale shuma prej 7,198 euro këtu na ka ik edhe 23 cent që duhet të jet 7,198.23 euro për shkak që duhet të barazohet shuma prej 722,446.53 euro.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 11:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=IJr74rzNucM>

**Procesmbajtësja,**  
**znj. Donjeta Morina**

---

**KRYESUES I KUVENDI,**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**

---



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 18 Qershor 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

### KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-01/45794  
Pejë, date: 18 Qershor 2024

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**  
**-Komiteti për Politikë e Financa-**



KRYETAR I KUVENDIT,  
z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52, pika 2, të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takim in e mbajtur me datë: 18 Qershor 2024, në rekomandim DÇPJ-së dhe propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

### KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik., siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 463-01/46363, datë  
Pejë, date: 18 Qershor 2024

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**  
**-Komiteti për Politikë e Financa-**







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 18 Qershor 2024, në rekomandim DZHE dhe propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

### KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton raportin (informatën) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës, si raport informativ, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-01/45814  
Pejë, date: 18 Qershor 2024

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**  
**-Komiteti për Politikë e Financa-**





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 18 Qershor 2024, në rekomandim DZHE dhe propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

### KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton raportin (informatën) rreth aktiviteteve të KKS-së, si raport informativ, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-01/45817  
Pejë, date: 18 Qershor 2024

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**  
**-Komiteti për Politikë e Financa-**



**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT  
MAYOR OFFICE  
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEČ



Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 11.06.2024 pas shqyrtimit të Kornizës afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Pejës për vitin 2025-2027, merr këtë,

### K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë, Kornizën afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Pejës për vitin 2025-2027.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Shërbimi i Zyrës së Kryetarit të Komunës KK Pejë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

L.nr. 400-01/43799 / 2024  
Pejë, 11 Qershor 2024

KOMUNA E PEJËS



Gazmend Muhaxheri  
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT  
MAYOR OFFICE  
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEČ



Në naze të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i komunës më datën 11.06.2024, merr këtë:

### K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë, raportin informativ rreth aktiviteteve të KKSB-së.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Zyra e Kryetarit

Konkluzioni dërgohet:  
Zyres së Kryetarit,  
Anëtarëve të KPF, dhe  
Arhives

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 600.01/45813 2024  
Pejë, 11 Qershor 2024

  
Gazmend Muhaxheri  
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT  
MAYOR OFFICE  
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEČ



Në naze të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i komunës më datën 11.06.2024, merr këtë:

### K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë, raportin informativ mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në komunën e Pejës.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik.

Konkluzioni dërgohet:  
Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik,  
Anëtarëve të KPF, dhe  
Arhives

L.nr. 400.01/45814 / 2024  
Pejë, 11 Qershor 2024

KOMUNA E PEJËS





## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

**Nr. Protokolit:**

**Data: 18.06.2024**

**Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës**

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

### THËRRET


Të merrni pjesë në mbledhjen e VI të rregulltë për vitin 2024, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 28.06.2024 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

*Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

### RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalve të Kuvendit të Komunës së Pejës (seancës së jashtëzakonshme dt. 16.04.2024, seancës së dt. 26.04.2024 dhe seancës së dt. 28.05.2024).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr. 22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.
6. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
7. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar (për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Hënën me dt. 27 Qershor 2024).
9. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

**KRYESUES I KUVENDIT**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

KAB PEJË

# Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2025-2027

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2025-2027

3.5 Politikat e reja

3.6 Shtojca/Investimet kapitale




## I.Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2025/2027 të pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së resurseve komunale për periudhën 2025-2027. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme :



Komuna ka filluar ciklin buxhetor me shqyrtimin e prioritetëve nga viti paraprak, duke bërë një analizë të shpenzimeve dhe të hyrave të planifikuara dhe realizuara. Dokumenti është ndarë me të gjitha drejtoritë/sectorët si kontribut për ciklin vijues buxhetor.

Si fazë e dytë drejtoritë komunale janë mbledhur dhe kanë diskutuar formularët për plotësim nga secili program/drejtori në të cilat do të shpaloseshin kërkesat e tyre buxhetore si dhe të hyrat komunale, për ato drejtori që realizojnë të tilla.

Drejtoritë e komunës kanë filluar me plotësimin e këtyre formularëve për shpenzime dhe të hyra për periudhën afatmesme buxhetore pasi kanë pranuar qarkoren e brendshme buxhetore me kufinj të buxhetor të përcaktuar dhe shpalosur në qarkoren e parë buxhetore që ka lëshuar Ministria e Financave dhe Transfereve.

Takime sqaruese dhe konsultuese janë zhvilluar me drejtori të caktuara sipas kërkesave dhe nevojës deri në takimin e radhës kur kërkesat buxhetore dhe të hyrat për periudhën afatmesme janë vendosur.

Drejtoria për buxhet dhe financa në bazë të kërkesave të pranuar dhe shqyrtuara buxhetore si dhe planit për të hyrat ka përpiluar dokumentin në vijim, i cili do t'i dorëzohet Asamblesë komunale për shqyrtim dhe së fundi Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.<sup>1</sup>

## **II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore**

Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme -shpronime - impianti Gorozhdec	800,000.00	800,000.00	400,000.00
Ndërtimi Sheshit Shkelzen Haradinaj - Haxhi Zeka		1,000,000.00	1,000,000.00
Ndërtimi i Hapësirave të Drini i Bardhe		200,000.00	200,000.00
Ndërtimi i rrugës së Bjeshkës së Jabllanices së Vogel		300,000.00	300,000.00
Ndërtimi i rrugës Varri i Sykut - Qafe Hajle		500,000.00	500,000.00
Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme	123,185.00	150,000.00	
Ndërtimi i impiantit në fshatin Kryshec	200,000.00		
Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit	200,000.00	500,000.00	
Ndërtimi i impiantit në Kuqishtë			750,000.00
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Kamenicë, Çallapek, Zllapek, Kryshec dhe Turjakë	89,548.30		
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Zahaq, Qyshk, Katundi I Ri, Leshan, Kliqinë, Ozdrim dhe Dubovë	157,790.00		
Ndërtimi i rrugëve dhe trotuarve në qytet	500,000.00	500,000.00	800,000.00
Ndërtimi i rrugëve në fshatra	600,000.00	500,000.00	800,000.00
Ndërtimi i sheshit prej ures së zallit deri te		500,000.00	500,000.00
Regullimi i infrastrukures për rreth bizneseve në hapësirave publike	150,000.00	250,000.00	250,000.00
Ndërtimi i rrugës në zonën industriale në Zahaq	100,000.00		650,000.00
Ndërtimi i rrugëve në lagjet Karagaq, Kapeshnice dhe Puhovc, Jarinë, Asllan Çeshme, Xh. Kada dhe Kristal	185,459.24		
<b>Totali - Infrastruktura Rrugore - Pejë</b>	<b>6,896,879.12</b>	<b>7,219,675.52</b>	<b>8,200,000.00</b>



<b>195950 - Zyra komunale për komunitete dhe kthim</b>			
Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Vitomiricë, Zllapek dhe Çungur dhe Brestovik	537,090.00	420,000.00	450,000.00
<b>Totali - Zyra komunale për komunitete dhe kthim</b>	<b>537,090.00</b>	<b>420,000.00</b>	<b>450,000.00</b>
<b>470190 - Bujqësi - Pejë</b>			
Ndërtimi kanaleve të ujitjes në regjionin e lugut të Baranit, Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fusha e Pejes	500,000.00	450,000.00	475,660.00
<b>Totali - Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</b>	<b>500,000.00</b>	<b>450,000.00</b>	<b>475,660.00</b>
<b>480190 - Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik - Pejë</b>			
Projktet e zhvillimit ekonomike	200,000.00	200,000.00	200,000.00
<b>Totali - Zhvillimi Ekonomik</b>	<b>200,000.00</b>	<b>200,000.00</b>	<b>200,000.00</b>
<b>661000 - Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ - Pejë</b>			
Ndërtimi i kanaleve të Seravisë, Katundi I ri dhe fshati Zahaq	250,000.00	200,000.00	200,000.00
Gjelbrimi i hapësirës së rrugëve në qytet, Ura e Gurit-Duli dhe Tranzit	30,000.00	40,000.00	50,000.00
<b>Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi</b>	<b>280,000.00</b>	<b>240,000.00</b>	<b>250,000.00</b>
<b>741000 - Shërbimet e shëndetësisë primare</b>			
Ndërtimi i qendres multifunksionale të trajnimeve faza 2 në lagjen 2 Korriku	250,000.00	200,000.00	
Rindërtimet në QKMF -et	64,271.00	200,000.00	
Ndërtimi i QMFsë në Radac		100,000.00	100,000.00
Blerja e pajisjeve mjekësore aparat Radiologjik, Ortopan, aparat oksigjen formues dhe autoklav	60,000.00	80,000.00	60,000.00
Ndërtimi i Objektit të ri të QKMF-se		544,025.38	700,000.00
<b>Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale</b>	<b>374,271.00</b>	<b>1,124,025.38</b>	<b>860,000.00</b>
<b>755920 - Shërbimet Rezidenciale</b>			
Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuara në Vitomiricë	100,000.00	150,000.00	100,000.00
Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara		250,000.00	200,000.00
Shtëpia për mbrojtjen e fëmijëve	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Shtëpia e komunitetit për persona të moshuar	230,000.00	500,000.00	600,000.00
<b>Totali - Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale</b>	<b>380,000.00</b>	<b>950,000.00</b>	<b>950,000.00</b>
<b>850190 - Shërbimet Kulturore</b>			

Ndërtimi i palestres në Zahaq	330,000.00		
Blerja e inventarit në Qendrën Rinore Vitomericë dhe në Qendrën Kulturore Peja			
Rindërtimi I fushes se Basketbollit Valon Begolli si dhe Rindërtimi I Tereneve te tenisit Arben Zeka ne Brestovik			
Ndërtimi i Murit mbrojtës në Fushën e Futbollit në Novosellë dhe rindërtimi i zhveshtoreve			
Mbulimi i bazenit të hapur dhe vendosja e Outdoor fitnesit në parkun e vogël			
Blerja e arenës profesionale për boks si dhe skenës profesionale për ambiente të hapurave			
Ndërtimi i shtegut të Atletikës në lagjen Dardania			
Ndërtimi i palestrës së ish Partizanit për sportet luftarake dhe atletike	200,000.00	400,000.00	300,000.00
Ndërtimi I fushave te Voleyballit ne lagjen Dardania dhe ne Parkun e Madh		30,000.00	
Ndërtimi i Palestres së basketbollit në Lagjen Karagaq		200,000.00	500,000.00
<b>Ndërtimi i bibliotekës së Qytetit</b>			<b>550,000.00</b>
<b>Totali - Kulturë, Rini, Sport</b>	<b>530,000.00</b>	<b>630,000.00</b>	<b>1,350,000.00</b>
<b>Arsim dhe shkence</b>			
Blerja e kombibusve per shkolla	175,000.00		
Ndërtimi i Palestrës së Sportit në Fshatin Treboviq	100,000.00	200,000.00	
Ndërtimi i Palestrës së Sportit në Fshatin Llozhan		200,000.00	100,000.00
Ndërtimi i sallës së sporteve në Gllogjan	100,000.00		
Rindërtimi i Shkollave dhe Anekseve ne Nabergjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, Nabergjan dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice	300,000.00	300,000.00	301,894.00
Ndërtimi i shkolles te stacioni I autobuseve			800,000.00
Ndërtimi i qerdhes ne fsh Zahaq dhe Stacioni i Trenit			800,000.00
Ndërtimi i Palestrës së sportit në Trestenik	100,000.00	150,000.00	
Ndërtimi i Palestrës së sportit në shkollen fillore Smajl Hajdari			400,000.00
Ndërtimi i palestres së sporteve në Kryshec		200,000.00	200,000.00
Ndërtimi i palestres se sportit ne Dubove			400,000.00
Ndërtimi i Gjinnazit	1,000,000.00	1,444,025.38	
<b>Arsim dhe shkence</b>	<b>1,775,000.00</b>	<b>2,494,025.38</b>	<b>3,001,894.00</b>
<b>Totali - Arsim dhe Shkencë</b>			
<b>635 Totali</b>	<b>13,568,942.25</b>	<b>15,217,726.28</b>	<b>17,037,395.23</b>



**PËR :** Z.Gazmend Muhaxheri -Kryetar i Komunës Pejë.

Z.Rexhep Kurtbogaj –Kryesues i kuvendit Komunal Pejë .

**NGA:** Drejtor për Zhvillim Ekonomik

**Z. Nasret Hajrizi**

**LËNDA:** Raporti ( informatë ) mbi zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në komunën e Pejës, për periudhën - **Qershor – Dhjetor -2023 – Janar-Qershor 2024.**

**Data:** 10.06.2024

Në bazë të kërkesës **Tuaj** dhe duke u mbështetur në planin dhe programin e paraparë të punës për realizimin e punëve dhe detyrave po ju dergojm raportin për periudhen **Qershor-Dhjetor 2023 dhe Janar – Qershor 2024 për Drejtoratin për Zhvillim Ekonomik.**

**SHTOJCA :** RAPORTI

**VËREJTJE:** Raporti i paraqitur është i ndar në tri pjesë ku secila pjesë prezanton veç e veç punën e sektorve në DZHE.

## RAPORTI PËR PERIUDHËN QËRSHOR – DHJETOR 2023

1. Është punuar raporti narativ vjetor i punës për vitin 2023, janë bërë vlerësimet e stafit si dhe është punuar programi i punës për vitin 2023.

2. Kemi vazhduar me takimet dhe bashkëpunimet tjera me operatorët e turizmit nga sektori privat për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023. Gjatë kësaj kohe kemi takuar mbi 40 biznese të sektoreve të ndryshme të shërbimeve. Në takime është biseduar për zhvillimet në sektorin e turizmit dhe mundësit e bashkëpunimeve më të afërta në të ardhmen si dhe krijimin e një oferte më të konsoliduar.

3. Pjesë e punës ka qenë edhe takimi me OJQ-të nga Peja të cilat mund të kontribuojn në zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës. Takimet kanë qenë të bazuara në temat për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe mundësit e bashkëpunimeve në projektet e ardhshme si dhe kordinimi i mundshëm i projekteve për zhvillim të përbashkët.

4. Menaxhimi i Zyrës Informative të Turizmit. Në këtë aspekt në kontinuitet kanë vazhduar punët përgatitëse për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve turistike të komunës, shërbimet e nevojshme informative për turistë si transporti, akomodimi, informata rreth shtigjeve etj. Të dy zyret informative janë aktive dhe funksionojn sipas planifikimeve. Vlen të theksohet se këto zyre janë duke u vlerësuar shumë nga të gjith akterët e turizmit për punën profesionale si dhe asociacioni i komunave është duke organizuar vizita studimore me drejtorët e zhvillimit ekonomik të komunave tjera për të marr eksperiencë nga ne.

5. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave të vizitave në dy zyret informative. Statistikat janë të përpunuara për periudhën Janar – Dhjetor dhe numri total i vizitorve është 7465.

6. Interpretimi i statistikave nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitin 2023. Më poshtë do të gjeni të paraqitura statistikave të realizuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitet 2022 - 2023.

PEJA	2022		2023	
	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje
	74.039	222.652	148.769	653.776

**Shënim:** Nga krahasimi i viteve më lartë në tabele shohim se kemi një rritje të numrit të vizitorëve si dhe net fjetje.

Viti 2023 ka filluar me një ritëm shumë të mirë të qarkullimit të vizitorëve por ajo që vlen të theksohet është qëndrueshmëria në net fjetje. Statistikat që janë publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për 10 muajt e vitit kemi 100.204 vizitorë dhe 460.984 net fjetje. Shifrat tregojnë një sukses mjaft të mirë në zhvillimin e turizmit në Komunën e Pejës, ndërsa vizitorin kemi arrit të mbajmë gati 5 net në krahasim me Prishtinën që vizitori qëndron vetëm 1 natë ndërsa Prizrenin ku vizitori qëndron vetëm disa orë.

7. Edhe në vitin 2023 kemi vazhduar me menaxhimin e rrjeteve sociale të cilat kanë një ndikim të madh në promovime andaj këto media sociale janë shfrytëzuar për qëllim të promovimit në masë më të madhe dhe janë menaxhuar vazhdimisht faqet në:

- **Facebook** - "Peja Tourist Information";
- **Instagram** - "Visitpeja" dhe "Pejaturism";
- **Twitter** - "Visitpeja" dhe "PejaTourism"
- **LinkedIn** – Peja Tourist Information Office
- Gjithashtu kemi gjithmonë të angazhuar në plotësimin e web faqes me të dhëna të reja.

**8.** Kemi vazhduar bashkëpunimi me MINT-Divizionin e Turizmit. Kemi qenë pjesë e zhvillimeve dhe bashkëpunimet tjera në furnizimin me materjal promovues për pjesëmarrje në panaiere si dhe pjesë e zhvillimit të platformes online të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

**9.** Kemi zhvilluar takime me organizatën SwissContact me të cilët kemi biseduar për zhvillimin e punëve dhe projekteve. Tani jemi duke pregaditur për nënshkrimin e Mou për certifikimin e produkteve turistike si dhe punimin e hartës turistike.

**10.** Ka vazhduar bashkëpunimi me grupin kordinues në mes të Pejës, Shkodrës dhe Plavës për projektin “Majat e Ballkanit”. Gjithashtu në bazë të vlerësimeve nga Tour Operatorët viti 2023 ishte viti më i mirë që nga viti 2013 për numër të vizitorve në shtegun Majat e Ballkanit.

**11.** Kemi marr pjesë në dy panaiert ndërkombëtare të cilat janë zhvilluar në Kosovë dhe Shqipëri ku kemi prezantuar destinacionin e Pejës si vend turistikë. Vlenë të theksohet se në të dy panaiert Peja është vlerësuar me notën më të madhe si destinacion me prezantim më të mirrin në nivel nacional dhe në nivel Shqipëris.

**12.** Kemi marr pjesë aktive në hartimin e Strategjis për Zhvillim Lokal Rural e organizuar nga GLV Agroturizmi ku kemi jepë mbështetje në zhvillimin e turizmit rural.

**13.** Kemi marr pjesë aktive në grupin punues për hartimin e dokumentit për Menaxhimin e “Çarshisë së Pejës” e cila është udhëhequr nga OSBE dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore.

**14.** Me ftesë të EU projektet IPA cross border kemi marrë pjesë në takimin dhe lansimin e video promovimit të projekteve ndërkufitare ku Peja ka qenë i përfshirë edhe në panel

diskutimi si një storie suksesi për zhvillimin e projekteve dhe të turizmit të qëndrueshëm.

## **PROJEKTET ME BUXHET KOMUNAL**

Të gjitha projektet janë shpallur dhe janë nënshkruar kontratat.

*Projektet të cilat kanë përfunduar janë:*

- Promovimi i destinacioneve turistike të Pejës – 21.453.00 Euro
- Digjitalizimi i arkives së shoqatës bjeshkatore Gjeravica - 6.565.00 Euro
- Panairi Veror – 19.990.00 Euro
- Panairi Dimëror – 19.890.00 Euro
- Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve turistike në bjeshkët e Lipës - bjeshkët e Podgurit 39.820.00 Euro
- Inveshimet në infrastrukturë të burimit të Drinit të Bardhë – LOT 1= 29.450.00 + LOT 2 = 41.655.90 LTO 1+2= 71.105.90 Euro
- Vendosja e monitorit interaktiv të hyrja e zyrës informative të turizmit – 14.700.00 Euro
- Projekte në proces: Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza – II – 24.350.00 Euro
- Projekte turistike – Shtigjet e bjeshkës së Jabllanicës - 8.384.00 Euro

*Në proces të punës janë:*

- Projekte në Proces: Turizmi i Aventurës – Projekti në bashkëpunim me MAPL (pjesa e MAPL ka përfunduar dhe një pjesë e komunës në shumë prej 40.000.00 Euro është realizuar ndërsa pjesa tjetër sipas marrëveshjes së nënshkruar pritet të realizohet në vitin 2024 kapë vlerën 57.210.00 Euro).

- Ndërtimi i strehimoreve në shtigjet turistike (ky projekt dy herë ka qenë i tenderuar). Në tenderimin e parë nuk ka marr pjesë askush ndërsa në heren e dytë është shpall fituesi por ka pasur ankesa kështu që ka ndikuar që ky projekt për shkak të motit të keq të bartet për vitin 2024. Nënshkrimi i kontraktës do të bëhet me datë 22.12.2023 ndërsa vlera e projektit është 36.450.00 Euro.

**VËREJTJE:** Dy projektet: “Rregullimi i hapësirës te KM 5’të” në Rugovë dhe projekti “Rregullimi i ujëvares në Shtupeq të Madh” janë planifikuar të zhvillohen nga projekti Via Dinarica dhe do të implementohen në vitin tjetër në vlerë prej 40.000 Euro. Këto projekte janë përgjegjësi e Organizatës Italiane CELIM në realizim dhe do të realizohen në vitin 2024.

#### **PROJEKTET ME DONATORËT TJERË**

Projektet në përgjithsi janë duke u implementuar në mënyrën më të mirë të duhur. Nuk ka ndonjë vërejtje sa i përket rrjedhës së projekteve.

#### **Projektet me fondet e EU – Programi ndërkufitarë Kosovë – Mali i Zi**

Tani si drejtorat jemi përfitues të dy projekteve të reja ndërkufitare nga forndet IPA-2 2020-2022 dhe bashkëfinancuar nga komuna e Pejës të cilat duhet të zhvillohen në afatin 2022 – 2024.

- **NERA – Neë Environment Revitalization Approach** - me vlerë prej 479.027 ku vlera për pjesën e Pejës është 223.774 ndërsa participimi i komunës është 42.900 Euro
- **Turning our village in tourism destination** - me vlere prej 456.106 Euro ku vlera për pjesën e Pejës është 228.000 dhe participimi i komunës është 34.208 Euro

Projekti i parë ka të bëjë me zhvillimet në mbrojtje të ambientit ndërsa projekti i dytë ka të bëjë me zhvillimin e turizmit rural.



## **Projekti NATURKOSOVO**

Projekti është iniciativë e qeveris Italiane e cila e ka dhuruar fondin ndërsa implementues të projektit do të jenë organizatat Italiane CESVI dhe CELIM. Projekti ka të bëjë me zhvillimin e turizmit malorë në komunat Pejë, Deçan dhe Junik. Projekti parasheh zhvillime të reja në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerzore përmes trajnimeve, intervenim në infrastruktur dhe promovim të destinacionit dhe kap vlerën 1.800.000 Euro. Projekti ka filluar implementimin dhe është bërë vlerësimi i shtegut Via Dinarica, janë zhvilluar trajnime për kërkim shpëtim si dhe pritet të lansohet thirja për zhvillimin e bizneseve lokale. Tani është faza ku do të ndahen grante për biznese në vlerë prej 360.000 Euro për tri komunat Peje, Decan dhe Junik. Përmes këtij projekti do të investohen edhe 40.000 Euro në infrastrukturën turistike në komunën e Pejës.

## **PROJEKTI “TOURISM FOR FUTURE”**

Është projekt ndërkufitar më Malin e Zi ndërsa komuna është bashk-financuese. Projekti ka të bëjë me Certifikimet e destinacionit dhe bizneset me standardin internacional EcoLabel duke krijuar mundësi të menaxhimit të vetqëndrueshëm të turizmit në Pejë. Edhe ky projekt parasheh ngritje të kapaciteteve njerzore, infrastrukturë të lehtë, zhvillimi i aktiviteteve për çertifikime dhe promovim të Pejës si destinacion të qëndrueshëm dhe EcoTurizem.

### 1. RAPORTI I SEKTORIT TË TURIZMIT

1. Është punuar raporti narativ vjetor i punës për vitin 2023, janë bërë vlerësimet e stafit si dhe është punuar programi i punës për vitin 2024.

2. Kemi vazhduar me takimet dhe bashkëpunimet tjera me operatorët e turizmit nga sektori privat për periudhën Janar – Qershor të vitit 2024. Gjatë kësaj kohe kemi takuar mbi 15 biznese të sektoreve të ndryshme të shërbimeve. Qëllimi i takimeve ka qenë i orjentuar në marrjen e sa më shumë informatave për zhvillimet në sektorin e turizmit dhe mundësit e bashkëpunimeve më të afërta në të ardhmen me qëllim të krijimit të një oferte më të konsoliduar dhe më të pasur për të plasuar pastaj në nivel vendi dhe ndërkombëtar.

3. Pjesë e punës ka qenë edhe takimi me OJQ-të nga Peja të cilat kontribuojnë në zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës. Janë diskutuar tema të ndryshme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe mundësit e bashkëpunimeve në projektet e ardhshme si dhe kordinimi i mundshëm i projekteve turistike.

4. Menaxhimi i Zyrës Informative të Turizmit. Kemi vazhduar me punët në kontinuitet për një menaxhim sa më të mirë të këtyre zyreve informative. Janë zhvilluar punë përgatitëse për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve turistike të komunës, shërbimet e nevojshme informative për turistë si transporti, akomodimi, informata rreth shtigjeve etj. Zyret informative janë aktive dhe funksionojnë sipas planifikimeve. Vlen të theksohet se këto zyre janë duke u vlerësuar shumë nga të gjithë akterët e turizmit për punën profesionale si dhe asociacioni i komunave është duke organizuar vizita studimore me drejtorët e zhvillimit ekonomik të komunave tjera për të marrë eksperiencë nga ne.

5. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave të vizitave në zyret informative. Statistikat janë të përpunuara për periudhën Janar – Dhjetor 2023 dhe numri total i vizitorve është 11.657 që kanë kërkuar informacion në zyre, dhe Janar – Maj 2024 kanë kërkuar 3.120 vizitorë.

6. Interpretimi i statistikave nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Në tabelle më poshtë do të gjeni një kronologji të paraqitur nga agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitet 2020 deri 2023.

PEJA	2020		2021		2022		2023	
	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje
	42.521	97.121	76.013	157.601	74.039	222.652	148.769	653.776

**Shënim:** Në këtë kronologji shihet se kemi një zhvillim të qëndrueshëm të ritjes së numrit të vizitorve por ajo që vlerësohet është ngritja e numrit të net fjetje të vizitorve. Në vitin 2023 shihet se kemi pasur gati 5 net qëndrimi të një vizitori ndërsa kjo e tregon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Komunën e Pejës. (krahasim me Prishtinën që një vizitor qëndron 2 netë ndërsa në Prizren 1 natë).


Mërsa për vitin 2024 deri në muajin Prill kemi 41.203 vizitorë ndërsa netfjetje kemi 117.448.

7. Edhe në vitin 2024 kemi vazhduar me menaxhimin e rrjeteve sociale të cilat kanë një ndikim të madh në promovime andaj këto media sociale janë shfrytëzuar për qëllim të promovimit në masë më të madhe dhe janë menaxhuar vazhdimisht faqet në:

- **Facebook** - “Peja Tourist Information” Culture ;
- **Instagram** - “Visitpeja” dhe “Pejaturism” ;
- **Twitter** - “Visitpeja” dhe “PejaTourism”
- **LinkedIn** – Peja Tourist Information Office

- **Facebook te projekteve** - "Culture Heritage Treasure of Cross border Region dhe Accursed Mountains Kosovo të cilat gjithashtu promovojn komunën tonë por edhe rajonin;
- Gjithashtu jemi gjithmon të angazhuar në plotësimin e ëeb faqes me të dhëna të reja.

Të gjitha këto kalojnë mbi 10.000 ndjeks ndërsa vizitueshmëria arrin mbi 100.000 ndjekës.



**8.** Kemi vazhduar bashkëpunimi me MINT-Divizionin e Turizmit. Kemi qenë pjesë e zhvillimeve dhe bashkëpunimet tjera në furnizimin me materjal promovues për pjesëmarrje në panairë si dhe pjesë e zhvillimit të platformes online të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

**9.** Kemi zhvilluar takime me organizatën SwissContact me të cilët kemi biseduar për zhvillimin e punëve dhe projekteve. Kemi nënshkruar MoU për certifikimin e produkteve turistike, punimin e hartës turistike si dhe marrëveshjen për punimin e strategjis së turizmit.

**10.** Ka vazhduar bashkëpunimi me grupin kordinues në mes të Pejës, Shkodrës dhe Plavës për projektin "Majat e Ballkanit". Gjithashtu në bazë të vlerësimeve nga Tour

Operatorët viti 2024 do të jetë gjithashtu një vit i mirë për numër të vizitorve në shtegun Majat e Ballkanit. Gjithashtu kordinime ka pasur edhe me projektet tjera si “Culture Heritage Treasure of Cross border Region” dhe “Accursed Mountains Kosovo”.

**11.** Kemi marr pjesë aktive në grupin punues për hartimin e dokumentit për Menaxhimin e “Çarshisë së Pejës” e cila është udhëhequr nga OSBE dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore.

**12.** Me ftesë të EU projektet IPA cross border kemi marrë pjesë në takime të ndryshme në promovimin e projekteve ndërkufitare, ndërsa në si drejtori kemi prezantuar në konferenca is shëmbull sukse si në menaxhimin e projekteve dhe vazhdimin e mirëmbajtjes së projekteve.

**13.** Së bashku me kryetarin kemi qenë pjesë e takimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të 5 komunave ndërkufotare për bashkëpunim të përbashkët. Komuna janë Peja, Deçani, Juniku nga Kosova, Plava dhe Gucia nga MALI i zi dhe Tropoja nga Shqipëria.

**14.** Kemi zhvilluar takim e të ndryshme me Universitetin Publik “Haxhi Zeka” për bashkëpunim ne Forumin Ekonomik Rajonal si dhe jemi në procesin e ndërtimit të Inkubatorit të Biznesit.

**15.** Kemi marrë pjesë në viziten studimore ne Grenoble në Francë të organizuar nga SwissContact dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Vizita është organizuar për disa komuna të Kosovës dhe pjesmarrës kanë qenë edhe kryetarë dhe drejtor të Zhvillimit Ekonomik. Qëllimi i viztës ka qenë marrja e eksperiencave të mira në zhvillimin e turizmit si dhe pjesmarrja në panairin e Grenoble si një ndër panairët më të mdha në Evropë për aktivitete në natyrë.

**16.** Kemi pasur takim me organizatën UNDP ku kemi pritur zyrtarët nga kjo organizatë dhe ekspertët nga Austria dhe Sllovenia me të cilët kemi diskutuar për zhvillimet në turizem e sidomos për ofertën e turizmit rural në Pejë.

**17.** Jemi ne takim të vazhdueshëm me Organizatën CDF ku në bashkëpunim me ta do të organizojm Panairin Verorë me 40 pjesmarrës të produkteve lokale duke e shëndruar në një ofertë unike që prezantoj arritjet e Pejës dhe rajonit, por edhe prezanton ofertën atraktive të qëndrimit në Pejë përmes ngjarjeve që do të zhvillohen në mbrëmje gjatë 3 ditëve.

## **PROJEKTET ME BUXHET KOMUNAL**

Jemi ne proces të shpalljes së tenderve ndërsa disa janë duke u realizuar.

*Projektet për vitin 2024 janë:*

- Hartimi i projektit për Zip Line dhe Kroje dhe Lugje – Projekti është duke u zhvilluar
- Materjale Promovuese - Projekti është duke u zhvilluar
- Panairi Veror – Projekti është duke u zhvilluar
- Panairi Dimëror - Pritet të dërgohet për prokurim
- Ndërtimi i Muzeut të Bjeshkatarisë- Është punuar Projekti kryesor për ndërtim dhe pritet të zhillohen procedurat e prokurimit
- Ndërtimi i Zip Line në zonën e Podgurit – Pritet të përfundoj projekti dhe të fillojm me procedura të prokurimit
- Ndërtimi i krojeve në bjeshëkt e Jabllanices, Gllavicë, Radac dhe Lipë – Pritet të përfundoj harimi i projekte dhe të vazhdojm me procedura të prokurimit.

*Në proces të punës gjithashtu janë:*

- Projekte në Proces: Turizmi i Aventurës – Projekti në bashkëpunim me MAPL (pjesa e MAPL ka përfunduar dhe një pjesë e komunës është duke u realizuar).
- Ndërtimi i strehimoreve në shtigjet turistike (ky projekt dy herë ka qenë i tenderuar). Në tenderimin e parë nuk ka marr pjesë askush ndërsa në herën e dytë është shpall fituesi por ka pasur ankesa kështu që ka ndikuar që ky projekt për shkak të motit të keq të bartet për vitin 2024. Jemi duke pritur lejen nga Agjincioni i Pylltarisë pasi që ata janë pronar të tokës ku do të ndërtohen strhimoret.

## **PROJEKTET ME DONATORËT TJERË**

Projektet në përgjithsi janë duke u implementuar në mënyrën më të mirë të duhur. Nuk ka ndonjë vërejtje sa i përket rrjedhës së projekteve.

## **Projektet me fondet e EU – Programi ndërkufitarë Kosovë – Mali i Zi**

Tani si drejtorat jemi përfitues të dy projekteve të reja ndërkufitare nga fondet IPA-2 2020-2022 dhe bashkëfinancuar nga komuna e Pejës të cilat duhet të zhvillohen në afatin 2022 – 2024.

- **NERA – New Environment Revitalization Approach** - me vlerë prej 479.027 ku vlera për pjesën e Pejës është 223.774 ndërsa participimi i komunës është 42.900 Euro

Përmes këtij projekti kemi furnizuar kompanin e pastrimit “EkoSig” me pajisje të nevojshme si shara të ndryshme, trimer, kolica, lopata uniforma dhe kërkesa tjera. Gjithashtu do ti furnizojm me thithëse pluhuri automatike si dhe më një kamionet që do të shërbejnë për një menaxhim më të mirë të punës dhe për një qytet më të pastër. Përmes këtij projekti kemi realizuar edhe “Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2028” si një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Pejës.

Gjithashtu në 6 shkolla janë mbajtur trajnime për vetëdijësim për ambient ndrsa ato 6 shkolla dhe 4 institucione tjera publike do të përfitojn nga 4 kontiner të vegjel plastik (në përgjithsi 40) për sortim të mbeturinave. Projekti parasheh të vendosen edhe 40 shporta të mbeturinave nga metali përgjatë lumit Lumbardhi dhe do të bëhet pastrimi i 10 hapësirave ilegale me mbeturina të cilat do të pajisen edhe me kariga dhe mbjelljen e pemve duke i shënruar në oaza të gjelbërta.

Gjithashtu përmes këtij krojekti kemi pasur bashkëpunim me kompanin rajonale "Higjena" ku kemi organizuar vizita studimore në Tuz për të shkëmbyer eksperiencia në menaxhimin e mebturinave. Këtë kompani e kemi furnizuar me 5.040 qese plastike për ti ndarë në 840 familje me qëllim të ndarjes së mbeturinave.

- **Turning our village in tourism destination** - *me vlere prej 456.106 Euro ku vlera për pjesën e Pejës është 228.000 dhe participimi i komunës është 34.208 Euro*

Përmes këtij projekti kemi zhvilluar trajnime për trajnime për banorët lokal në zonat rural të cilët ofrojn akomodime ndërsa aktivitetet tjera nga ky projekt kanë të bëjnë me zhvillimin e shtigjeve të ciklizmit në zonat rurale, sinjalizimi i tyre, sinjalizimi trashëgimis kulturore, interevenimi ne regullimin e hapësirave publike në fshatra, si dhe ndihma e banorve lokal për krijimin e kushteve më të mira për pritjen e vizitorve.

Gjithashtu projekti parasheh edhe pjesën e promovimit të ofertës turistike dhe përmes këtij proejkti do të ngrisin diversitetin e destinacionit turistik të Pejës duke e bërë një destinacion atraktiv për vizitor.

### **Projekti NATURKOSOVO**

Projekti është iniciativë e qeveris Italiane e cila e ka dhuruar fondin ndërsa implementues të projektit do të jenë organizatat Italiane CESVI dhe CELIM. Projekti ka të bëjë me zhvillimin e turizmit malorë në komunat Pejë, Deçan dhe Junik. Projekti parasheh zhvillime të reja në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerzore përmes



trajnimeve, intervenim në infrastruktur dhe promovim të destinacionit dhe kap vlerën 1.800.000 Euro. Projekti ka filluar implementimin dhe është bërë vlerësimi i shtegut Via Dinarica, janë zhvilluar trajnime për kërkim shpëtim. Tani është faza ku janë përcaktuar përfituesit nga stafi i projektit dhe do të ndahen grante për biznese dhe shoqata në tri komunat Pejë, Decan dhe Junik. Përmes këtij projekti do të investohen edhe 40.000 Euro që kanë filluar të punohet në regullimin e strehimorës të kilometrin e 5'të si dhe murin zbukurues ndërsa pritet të vazhdojn punimet në ujvaren e Shtupeqit të Madhë.

### **PROJEKTI “TOURISM FOR FUTURE”**

Është projekt ndërkuftar më Malin e Zi ndërsa komuna është bashk-financuese. Projekti ka të bëjë me Certifikimet e destinacionit dhe bizneset me standardin internacional EcoLabel duke krijuar mundësi të menaxhimit të vetqëndrueshëm të turizmit në Pejë. Edhe ky projekt parasheh ngritje të kapaciteteve njerzore, infrastrukturë të lehtë, zhvillimi i aktiviteteve për çertifikime dhe promovim të Pejës si destinacion të qëndrueshëm dhe EcoTurizem. Projekti ka përcaktuar 9 përfitues që do të certifikohen. Në si drejtorat bashkarisht me këtë projekt kemi organizuar edhe festivalin e Turizmit “Peja Tourism Outdoor Festival” që ka bërë bujë të madhe në promovimin e destinacionit tonë për turizmin e aventurës.



9	Refuzime	//	//	//	//	//	//	//	//	//	//	01	//	<b>01</b>
	<b>Lënd te procesuara gjatë vitit</b>	<b>24</b>	<b>33</b>	<b>22</b>	<b>39</b>	<b>21</b>	<b>04</b>	<b>02</b>	<b>23</b>	<b>38</b>	<b>37</b>	<b>31</b>	<b>25</b>	<b>298</b>

### 3. SEKTORI I REXHISTRIMIT TE BIZNESEVE

Raport për periudhen **Janar -Qershor 2023 – Janar Qershor 2024**

Datë : 10.06.2024

Nr.	Aktivitetet	Numri	Verejtje
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	539	<b>SHPK -386 SHA - 2, OP-3 BIZNES INDIVIDUAL 148</b>
2	Ndryshime ne biznes	258	
3	Shuarje te biznesit	39	
4	Kerkesa te Ndryshme Vertetime, ndrrime te certifikatave etj.	413	

Gjithësejt të perpunuara : **1249** lëndë

#### **4. Problemet**

Drejtoria për zhvillim ekonomik gjatë vitit 2023 e poashtu edhe në vitin 2024 është ballafaquar dhe duke u ballafaquar me mjaft probleme të natyrave të ndryshme që kanë shkaktuar vështirësi në zhvillimin e aktiviteteve të parapara në planin e punës.

Një nga problemet është mungesa e Strategjis për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Mungesa e stafit po e bënë mjaft të vështirë funksionimin e kësaj drejtorie. Pjesa e sektorit të turizmit në të cilën janë të pozicionuara projektet ka munges të stafit së pari për ta mbajtur hapur zyrën për Informacion Turistik edhe në vikende e gjithashtu në menaxhimin e kontratave ku një punëtor duhet të angazhohet me shumë punë të natyrave të ndryshme si në menaxhimin e zyreve informative, realizimin e projekteve infrastrukture, përcjellja e projekteve me donacionet e huaja, pjesëmarrj në takime strategjike, vizitat në terren etj etj. Gjithashtu në munges të stafit edhe në dy sektoret tjerë jemi të hendikepuar në pjesmarrjen e shumë takimeve strategjike si dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve njerzore.

Menaxhimi i kontratave është gjithashtu një sfid që i përcjell stafin e drejtoratit. Mungesa e trajnimeve për menaxhim të kontratave online ka bërë që puna jonë të jetë shumë më e vështirë në këtë drejtim.

Mungesa e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve njerzore. Stafi nuk ka trajnime të cilat do të ndikojn në ngritjen e cilësis së menaxhimit edhe pse çdo vitë i kërkohet dhe i dergojn se çfar lloj trajnime kanë nevoj ti ken.

## **5. Rekomandim**

Rekomandojm që në të ardhmen të mundësohet punësimi i së paku 4 (katër) personave që do të udhëheqin punë specifike në sektorin e turizmit, të trajtohen disa mundësi së paku për trajnime të stafit me qëllim të profesionalizimit për një menaxhim më të mirë.



Raport informativ i Këshillit Komunal për  
Siguri në Bashkësi (KKSBB), në komunën e Pejës

Dt. 04.06.2024

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)** funksionon në kuadër të komunës si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë në bashkëpunim me policinë dhe anëtarët tjerë të KKSBB-së, ku analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë.

Gjatë pesë mujorit të parë të vitit 2024, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur dy takime.

Takimi i parë u mbajt më dt. 29.02.2024, më këtë rend dite:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSBB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSBB-së nga ana e koordinatorit – **z. Fatmir Asllani**, prezentimi i rendit të ditës, planit të punës dhe aprovimi;
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në Komunë – kryetari i komunës **z. Gazmend Muhaxheri**
- Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës – **Komandanti i Stacionit të Policisë z. Idriz Atashi**;
- Arsimi, gjendja në shkolla dhe situata e zhvillimit të procesit arsimor. Siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme – **drejtori i DKA-së z. Naser Gega**;
- Diskutime dhe Pyetje nga anëtarët e KKSBB-së;
- Konkludime, Rekomandime.

Ky takim iu dedikua gjendjes aktuale në komunë, gjendjes së sigurisë në komunë, gjendjes në shkolla dhe situatës së zhvillimit të procesit arsimor, sigurisë në shkolla, përdorimit të substancave narkotike dhe bartjes së mjeteve të rrezikshme.

Takimin e hapi koordinatori i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi rendin e ditës dhe planin e punës, i cili është aprovuar nga anëtarët e rregullt.

Kryetari i komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë. Këtë vit e kemi filluar me disa projekte, të cilat kanë mbet pa u përfunduar nga viti i kaluar, pra këtë vit me plan të punës dhe plan të prokurimit e kemi rregullimin e sheshit, rregullimin e kanalizimeve të dyqaneve në shesh, vendosjen e rrymës nëntoksore në shesh,

gjelbërimi ka me qenë i rikuperushëm dhe në funksion të qytetarëve, ndërtimin e urave njëra, e cila e lidh Puhovcin me Kapeshnicën, ndërsa ura tjetër fillon nga Kombinati i Lëkurkepucëve, e cila e lidh pjesën me restorant "Universin" edhe del poshtë në rrugën për Prishtinë, vazhdimi i shëtitores, grantin e performancës, të cilin e kemi fitu është 1 milion e 752 mijë, janë 22 projekte të shpërndara nëpër fshatra dhe qytet, në pjesë të ndryshme për rregullim urban, punimi i ambulancës së re në fshatin Trestenik, do të përfundojë edhe shtegu i shëndetit hapësira tek uji i zi, punimet te kanali te furra "Husaj" dhe në lagjen "Fidanishte", rregullimin komplet të lagjes "Fidanishte" me kubëzim dhe ndriçim edhe rregullimin e kanalit mbi shkollë, ndërsa 280 mijë euro i kemi ndarë për rregullim të kanalit në lagjen "2 Korriku", rruga "Maja e Zezë" - Vitomiricë është përfunduar, ka filluar ndërtimi i çerdhes te Shkolla e Mesme Ekonomike "Ali Hadri", e cila do të jetë një çerdhe e madhe, që do të përfundojë në vitin 2025, janë 68 kilometra rrugë në fshatra, që bëhen, pastaj janë 7 kilometra rrugë në qytet edhe janë 36 kilometra rrugë në Rugovë.

Drejtori për Arsim në komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor, sigurinë në shkolla, përdorimin e substancave narkotike dhe bartjen e mjeteve të rrezikshme.

Takimin me këshillin e prindërve dhe drejtorë të shkollave i kemi të vazhdueshme në DKA dhe të gjitha ato vështirësi që i hasim në terren, merremi automatikisht me to për tejkalimin e tyre. Nuk kemi asnjë rast të raportuar përdorimin e substancave narkotike dhe bartjen e mjeteve të rrezikshme për këtë vit. Bulizmin në shkolla, fyerjet, ofendimet dhe ngacmimet të tilla në rastin e parë që hetohet mirren masa adekuate që këto të tejkalohej, qoftë raporti nxënës-nxënës ose mësimsdhënës-nxënës.

Një problem më vete në shkolla, edhe pse jemi në kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Stacionin Policor, paraqesin veturat e ndaluara para shkolle, ku prindërit i sjellin fëmijët në shkollë, duke filluar prej Gjimnazit "Bedri Pejani", ish dashtë gjithsesi, s'paku prej ores 12-13.00, të jenë prezent policia.

Pushimin papagesë të stafit, sidomos pas liberalizimit të vizave, e kemi reduktuar në minimum sepse synimi kryesor është që nxënësi s'bën të mbetet asnjë moment pa mbulesë - pa mësimsdhënësin adekuat.

Në vazhdim anëtarët kanë paraqitur shqetësimet dhe kërkesat e tyre bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

Takimi i dytë u mbajt më dt. 22.05.204, më këtë rend dite:

Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSB-së;

Hapja e mbledhjes së KKSB-së nga ana e koordinatorit – **z. Fatmir Asllani**, prezentimi i rendit të ditës, procesverbali i mbledhjes së takimit të kaluar dhe aprovimi;

- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në Komunë – kryetari i komunës **z. Gazmend Muhaxheri**
- Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës – **komandanti i Stacionit të Policisë z. Idriz Atashi;**
- Arsimi, gjendja në shkolla dhe situata e zhvillimit të procesit arsimor. – **DKA-së z. Naser Gega;**
- Shitja/Blerja e ushqimit të përditshëm, prodhim i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve – **Drejtorja e Inspektionit,**

- Aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale. Mbeturinat – Drejtoria e Inspekcionit, **znj. Edonjeta Berisha**.
- Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore – Qendra për Punë Sociale dhe **Znj. Ardita Bala** – drejtoreshë në Qendrën për Mirëqenien e Gruas, Pejë
- Identifikimi i brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me sigurinë publike – përfaqësuesja e KLSP-së, Nora Draga;

Diskutime dhe Pyetje nga anëtarët e KKSB-së;

Konkludime, Rekomandime.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takimin e radhës.

Takimin e hapi koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi rendin e ditës, i cili është aprovuar nga anëtarët e rregullt.

Kryetari i komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë.

Raportin për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës e prezantoi Komandanti i Policisë z.Idriz Atashi.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor dhe sigurinë në shkolla.

Drejtoria e Inspekcionit prezantuan gjendjen e Shitje/Blerjes së ushqimit të përditshëm, prodhimi i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve dhe aktivitetin e tyre për parandalim dhe kontrollim.

Aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale të mbeturinave e prezantoi Drejtoresha e Inspekcionit, znj. Edonjeta Berisha.

Agim Mala-udhëheqës i shërbimit social pranë QPS-së në Pejë, foli për dhunën në familje dhe mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore.

Nora Draga përfaqësuese e KLSP-së, foli për identifikimin e brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me sigurinë publike.

Diskutime dhe pyetje nga anëtarët e KKSB-së, konkludime dhe rekomandime.

Me respekt koordinatori i KKSB-së,

z. Fatmir Asllani





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

**L.Numër: 01-060/01-0037697**

**Pejë, datë: 28 Maj 2024**

### PROCESVERBAL

Nga takimi i –V- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **28 maj 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, znj.Hajrije Hxhijaj- zyrtare kryesore e financave, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 30 anëtarë prezent. Po ashtu deklaroi që pika e 3 hiqet nga rendi i ditës dhe u shtua edhe një pikë shtesë 14.Shqyrtimi i qarrkores buxhetore për vitin 2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 29 vota pro, kunder nuk ka,1 vote e përmbajtur, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

#### REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtëshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendi me qëllim të realizimit “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - shfuqizimit të Vendimit nr. 03/2024 me nr. protokollit 400-01/11637 datë 27 shkurt 2024 K.K. Pejë, mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për

- këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë” sipas PZHK.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit”Lumbardhë”dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë”sipas PZHK.
  7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.
  8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.
  9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.
  10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2024.
  11. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për vitet 2024-2028.
  12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin i inkubatorit të biznesit në Pejë
  13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hoteliereve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë me seli në Pejë.
  14. Shqyrtimi i qarrkores buxhetore për vitin 2025.
  15. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:
  16. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.**

Në takim mungoj z.Rrustem Berisha dhe z.Granit Kelmendi

### **2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.**

Mysafire nga projekti NERA, znj. Adela Brahovic .

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit.**

Kryesusi z. Rexhep Kurtbogaj: fillimisht do ta aprovojmë si nismë, pastaj kryetari i Komunës marrëveshjen me Komunën e Ulqinit dhe rradhës tjetër e aprovojmë vendimin e bashkëpunimit final.

Kryetari z. Gazmed Muhaxheri: Eshtë nismë e kahemotshme e kryetarve të Ulqinit ata kanë procedurë e marrëveshjes prej ministrisë edhe mandej krijohet nisma, ndërsa tek ne fillon nisma në asamble komunale dhe kur të arrihet marrëveshja e dergojmë në ministri do të thotë është një procedurë e kundërt ka qenë kërkesë para se të bëhet vllaznimi me komunën e Gusisë mire po me kërkesë të ambasadorit të atehershëm të Malit të Zi në Kosovë na është kërkuar ta bëjmë një vllaznim me komunën e Gusisë sepse ka pasë kryetare për herë të parë femer edhe ka qenë një komunë e vogël e cila ka pasë veshitirsia për të bërë vllaznim me komunat tjera kështu që e kemi aprovu dhe jemi vllaznu me komunën e Gusisë, tash është nisma tjetër do të thotë ka vazhdu nuk është heq dorë që Ulqini të vllaznohet me Pejën janë të dyja vende tursitike dhe kemi çka me shkëmby edhe përvoja edhe mundësi në bashkëpunim me një qytet siç është Ulqini.

Z. Islam Husaj: çka do të ndodh me atë iniciativën dhe atë nënshkrimin e marrëveshjes që e keni pasë bërë një kohë me Ulqinin?

Znj. Xhenet Syka Kelmendi: z.Husaj, është e vertetë që ka 4 vite nese nuk gabojmë që ka filluar një iniciativë por sikur e dini situata politike në Malin e Zi ekskluzivisht në Ulqin nuk ka qenë stabile dhe kohe pas kohe ka pasë edhe ndërrim të pushtetit edhe ndërrim të kualiteteve, dhe duke e ditur menaxhimin e politikave lokale në Mal të Zi përfshirë edhe Ulqinin do me thenë kryetarët varen decitivisht nga votat e kuvendarve dhe disa kohë pas kohë pa plan janë ndërruar kryetarët sepse janë ndërruar koalicionet politike që e përbejnë Asamblen e Ulqinit. Momenti është zgjedhur pikërisht sepse jemi në viti jubilar 25 të Ditës së Çlirimit të Pejës dhe me 01 qeshor, Asambleja e Ulqinit do ta zgjedhë kryetarin e ri dhe kemi menduar që është një mënyrë e mirë ardhja e tyre në Pejë dhe nënshkrimi i këtij ratifikimi kuptohet edhe zyretarizimi i tij duke i pasur parasysh lidhjet politike, ekonomike, dhe kulturore në komunën e Ulqinit.

Z. Islam Husaj: nuk mu përgjigje në pyetjen që e bëra unë, ne e kemi një nënshkrim, e kemi një marrëveshje ka qenë nënkryetarja e Ulqinit ktu në Pejë në Ditën e Çlirimit të Pejës kur e kemi bërë nënshkrimin edhe kryetari ynë edhe nënkryetari i Ulqinit, unë veç pyeta çka do të bëhet me atë nismë dhe me atë marrëveshje, ka qenë një marrëveshje e bashkëpunimit edhe me disa komuna tjera mirëpo edhe me Ulqinin!

Znj. Xhenet Syka Kelmendi: ajo nismë do të ratifikohet, nisma ka qenë si një iniciativë e cila nuk është prezantuar para asambleistëve, sod po prezantohet dhe ratifikimi i saj do të bëhet në ditën e Çlirimit të Pejës.

Z. Rajan Arapi: ne si subjekt politik i përkehim marrëveshjet, mirëpo e kam një propozim në këto marrëveshje të mos anashkalohet përfshirja e legjislativit, sepse zakonisht shohim që në marrëveshjet tjera legjislativi pak apo fare nuk përfshihet kështu që ta keni parasysh në të ardhmen.

